

## POLITIKAT E PRIVATESISE (MBROJTJA E TE DHENAVE PERSONALE)

Agjencia Kombëtare e Mjedisit mbledh dhe përpunon të dhënat e subjekteve të cilat ushtrojnë veprimtari që kanë ndikim në mjedis, në përmbushje të të drejtave dhe detyrimeve të saj ligjore dhe kontraktuale dhe në përputhje të plotë me Ligjin Nr.9887, datë 10.3.2008, « Për mbrojtjen e të dhënave personale » (të ndryshuar).

Në kuadër të përdorimit të faqes zyrtare të internetit [www.akm.gov.al](http://www.akm.gov.al), Agjencia Kombëtare e Mjedisit mund të mbledhë në mënyrë direkte të dhëna personale nëpërmjet plotësimit të Regjistrimit të kërkesave dhe përgjigjeve, nëpërmjet shqyrtimit të dosjeve të aplikimeve, të cilat regjistrohen në sistemet e saj dhe të Drejtorive Rajonale. Plotësimi i këtyre të dhënave është vullnetar.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit, siguron subjektet e të dhënave personale se të dhënat e tyre mbledhen dhe përpunohen vetëm për qëllime të realizimit të marrëdhënies kontraktore të shërbimit të ofruar nga AKM.

Duke përdorur portalin dhe/ose duke dhënë miratimin për rregjistrimin, subjektet e të dhënave japin pëlqimin për procesimin e mëtejshëm të tyre si dhe garantojnë që të dhënat personale të plotësuara janë të sakta, të vërteta dhe të përditësuara. Për më tepër, subjekti i të dhënave personale është përgjegjës për përditësimin e të dhënave të rregjistruara për të siguruar që informacioni është përditësuar vazhdimisht dhe në mënyrë të plotë.

Subjektet e të dhënave personale kanë të drejtë të kërkojnë akses në të dhënat e tyre si dhe të kërkojnë që këto të dhëna të korrigjohen apo të përditësohen në përputhje me kërkesat e nenit 13 dhe 18 të Ligjit 9887 datë 10.3.2008 « Për mbrojtjen e të dhënave personale ».

Agjencia Kombëtare e Mjedisit garanton se ka marrë të gjitha masat fizike, teknike dhe operacionale për ruajtjen e konfidencialitetit si dhe mbrojtjen nga humbja, shkatërrimi, dëmtimi apo edhe shpërndarja e pautorizuar, në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008, « Për mbrojtjen e të dhënave personale » (i ndryshuar) .

Të dhënat personale, të mbledhura dhe të ruajtura në databaza të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit , do të përpunohen nga punonjësit dhe / ose bashkëpunëtorët e kontrolluesit të të dhënave ose të atyre personave të ngarkuar me përpunimin. Këto të dhëna nuk do të transferohen ose komunikohen te palët të treta, përveç rasteve kur është dhënë pëlqimi ose kur ky informacion kërkohet nga organet kompetente sipas ligjit .

Subjektet e të dhënave kanë të drejtën e refuzimit të pëlqimit në çdo kohë për grumbullimin dhe përdorimin e të dhënave të tyre të njoftuara vullnetarisht si dhe të kërkojnë fshirjen e këtyre të dhënave duke ushtruar të drejtën e zgjidhjes së marrëveshjes mes palëve.

Duke u njohur me përmbajtjen e kësaj rubrike, subjektet e të dhënave kanë pranuar kushtet dhe termat në lidhje me politikat e privatësisë të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.